



Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-133921

Dt. 20.02.2026

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR KK – PRIZREN, me kërkesën e **Ylmije Krasniqi-Pulaj** me banim në rrugën “**Ilijaz Kuka**” nr.25 me numër të kërkesës **04-353/01-133921** të datës 10.10.2025 në bazë të nenit 3. pika 1.11 si dhe nenit 5 alineja 1 Pika 1.3 e në kuptim të nenit 14 alineja – 1 pika 1.5 dhe nenit 15 alineja 1 pika 1.1 dhe neni 19 alineja 2 të Ligjit për Ndërtim Numër 04/L-110 si dhe konform dispozitave të dhe neneve 26 paragrafi 1, nenet 27, 44, 46, 47, 48 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Pergjithshme Administrative-LPPA-së numër 05/L-031, e lidhur me dispozitat e neni 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe sipas vendimit për miratimin e HZK për periudhën 2022-2030 Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 merr këtë:

AKTVENDIM

I. **LEJOHET: Ylmije Krasniqi-Pulaj** me banim në rrugën “**Ilijaz Kuka**” në zhvillimin e punimeve: **Renovimin e kulmit** të objektit me numër **O-71813068-02728-0 ZK Prizren** e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-03058-2**, e cila është e identifikuar sipas kopjes së planit e vërtetuar nga ana e këtij shërbimi.

II. Dokumentacioni teknik e mban titullin e tipit të veçantë të punuar nga ana e byros projektuese “Root Studio” (gjendja e re dhe gjendja ekzistuese).

II. Gjatë renovimit nuk lejohet kurrfarë ndryshimi, zgjerimi në gabarit dhe në etazhitet të objektit.

III. Investitori duhet të përmbahet Vendimit të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve me nr.12/2026 të dt.21.01.2026

IV. Ditën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin e ndërtimtarisë në afat prej 8 ditësh dhe që të njoftojë QRTK-Prizren 7 ditë para fillimit të punimeve

V. Ky aktvendim pushon të vlejë në rast se me punë nuk fillohet brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh duke llogaritur nga dita e marrjes së të njëjtës.


Arsyetim

Nga dokumentacioni teknik si dhe të shtojcave tjera të prezantuara së bashku me kërkesë vërtetohet se: **Ylmije Krasniqi-Pulaj me banim në rrugën “Ilijaz Kuka”nr.25** me procedurën paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunëtorit profesional.

Duke shqyrtuar kërkesën e investitorit si dhe në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për renovimin e objekteve të KK Prizren, është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për **Renovimin e kulmit** të objektit me numër **O-71813068-02728-0** e cila është e locuar në ngastrën kadastrale numër **P-71813068-03058-2**, ZK Prizren.

KËSHILLA UDHËZUESE JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – MMPHI në Prishtinë, përmes këtij organi.

Bashkëpunëtor profesional:


Xhejlane Gjini, inxh. dip. ark.

